

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË  
FAKULTETI I MJEKËSISË

DEPARTAMENTI I PEDIATRISË

DISERTACION  
PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE  
“DOKTOR”

TEMA:

**ROLI I PROKALÇITONINËS (PCT) NË  
DIAGNOZËN E HERSHME TË SEPSISIT  
NEONATAL**

Kandidati:  
NIKETA KOLIÇI

Udhëheqës shkencor:  
Prof. ELI FOTO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË TIRANË  
FAKULTETI I MJEKËSISË  
DEPARTAMENTI I PEDIATRISË

**DISERTACION**

I PARAQITUR NGA  
**Znj. NIKETA KOLIÇI**

PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE  
**DOKTOR**

**SPECIALITETI PEDIATRI**

TEMA:

**ROLI I PROKALÇITONINËS(PCT) NË  
DIAGNOZËN E HERSHME TË SEPSISIT  
NEONATAL**

MBROHET MË DATË

PARA JURISË:

1. PROF.SASHENKA SALLABANDA .....KRYETAR
2. PROF.GJEORGJINA KULI..... ANËTAR (OPONENT)
3. PROF.RUBENA MOISIU..... ANËTAR (OPONENT)
4. PROF.AS. ZAMIRA YLLI.....ANËTAR
5. PROF. ARJAN HARXHI..... ANËTAR

# PASQYRA E LËNDËS

HYRJE.....  
RËNDËSIA E ZGJIDHJES SË PROBLEMIT.....

1. TË DHËNA MBI SEPSISIN NEONATAL DHE DIAGNOZËN E TIJ.....
2. PARAQITJA E STUDIMIT.....
  - 2.1. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT.....
    - 2.1.1. Qëllimi i studimit.....
    - 2.1.2. Objektivat e studimit.....
  - 2.2. MATERIALI DHE METODA.....
    - 2.2.1. Karakteristikat e popullatës së përfshirë në studim.....
    - 2.2.2. Marrja dhe definicioni i të dhënave.....
  - 2.3. ANALIZA STATISTIKORE.....
    - 2.3.1. Variablat e interesit.....
    - 2.3.2. Analiza statistikore.....
3. REZULTATET E STUDIMIT.....
  - 3.1. Rezultatet
4. DISKUTIM.....
5. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME.....

BIBLIOGRAFI.....

## SHKURTIME

PCT	Prokalçitonina
EOS	Sepsis neonatal i hershëm (Early Onset Sepsis)
LOS	Sepsis neonatal i vonë (Late Onset Sepsis)
GBS	Streptokok i Grupit B
NPV	Vlerë Prediktive Negative (Negative Predictive Value)
WBC	Leukocite
PLT	Trombocite
CRP	Proteina C Reaktive
IVU	Infeksion i Vijave Urinare
PROM	Plasje e parakohshme e membranave
MB	Mosha e Barrës

## **HYRJE**

*Sepsisi neonatal ka qenë dhe vazhdon të mbetet një problem madhor mbarëbotëror për shkak të shkallës së lartë të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë dhe jo vetëm në periudhën e të porsalindurit.<sup>1,2</sup> Megjithë përparimet në fushën e teknologjisë në fushën e kujdesit dhe të diagnostikimit dhe përdorimit të gjeneratave të reja të antibiotikëve, ky problem mbetet me një rëndësi të veçantë në periudhën e të porsalindurit, sidomos të atij të lindur parakohe për shkak të papjekurisë imunitare fiziologjike, por edhe të klinikës jo specifike. Çdo vit rreth 30 milionë të porsalindur preken nga infeksionet në mbarë botën dhe 1-2 milionë prej tyre vdesin.<sup>3</sup>*

*Edhe pse nuk ka punime të gjera për vlerësimin e saktë, incidenca e sepsisit neonatal varion nga 1-10 për 1000 lindje gjallë, dhe rreziku rritet deri në katër herë në të lindurit parakohe dhe me peshë lindjeje më të vogël se 1500 gr<sup>5,6</sup> në vendet e zhvilluara. Shifrat janë edhe më të larta në vendet në zhvillim ku mjetet janë më të kufizuara dhe studimet janë të pakta në numër dhe të dhënat shpesh jo të plota dhe në këto vende 4 në 10 të porsalindur vdesin nga infeksionet në periudhën neonatale ose mbeten me skela të përhershme të zhvillimit fizik dhe atij mendor.<sup>7,8,9,10</sup>*

*Nuk ka një konsensus të pranuar gjerësisht të përkufizimit për sepsisin neonatal. Pamundësia për të rënë dakord për një përcaktim të saktë zvogëlon në masë të madhe mundësinë e përafrimit të gjetjeve nga epidemiologët, klinikistët dhe studiuesit, gjë që, nga ana tjetër, vështirëson përparimin drejt përmirësimit të rezultateve.<sup>10</sup>*

*Megjithatë: Sepsisi neonatal konsiderohet si një sindrom klinik i karakterizuar nga një zinxhir ngjarjesh inflamatore dhe joinflamatorë, reaksionesh humorale dhe qelizore dhe njëkohësisht edhe ndryshimeve hemodinamike që pasojnë.<sup>4</sup>*

*Kështu që, në kushtet e një paraqitjeje klinike jospecifike dhe përdorimit për diagnozë të biomarkuesve me vlera parashikuese të ulëta, sidomos për sepsisin e hershëm, vendosja e diagnozës përbën një sfidë për klinikistët e përfshirë në kujdesin e të porsalindurit.<sup>11</sup> Shpesh në rastet e dyshuara për infeksion, nisat terapia empirike me antibiotikë, deri në pritje të rezultateve të testeve të përdorura për diagnozë, ndër to edhe të hemokulturës së kosideruar si “Gold standard” për diagnozën e sepsisit të provuar, duke u përpjekur në këtë mënyrë, me fillimin e hershëm të trajtimit, të përmirsohet prognoza dhe të ulet vdekshmëria në këto grupe pacientësh. Në vendet e zhvilluara rreth 4.0–7.4% e të porsalindurve të dyshuar për sepsis trajtohen me antibiotikoterapi empirike intravenoze të paktën 72 orë, edhe pse në këto vende prevalenca e sepsisit të provuar (me hemokulturë pozitive) është më pak se 1 për 1000 lindje gjallë.<sup>10,11,12</sup> Kjo tregon se antioikoterapia empirike është e panevojshme në shumicën e neonatëve, duke rritur ditëqëndrimin në spital, ekspozon ndaj rrisqeve të panevojshme të porsalindurit,*

bën selektimin e florës duke çuar në krijimin e rezistencave mikrobike, me pasojë rritjen e kostove nga përdorimi i panevojshëm i burimeve dhe mjeteve.<sup>13,14,15</sup>

Në këtë epokë të rezistencës në rritje ndaj antibiotikëve, OBSH ka theksuar nevojën urgjente të reduktimit të përdorimit të panevojshëm, apo shkurtimit sa të jetë e mundur, të antibiotikëve, sidomos në periudhën neonatale.<sup>16</sup> Kjo kërkon një konfirmim/përjashtim sa më të shpejtë të diagnosës së sepsisit në periudhën neonatale. Për këtë nevojiten mënyra dhe teste diagnostike me sensitivitetet dhe specificitetet më të lartë dhe që të shkurtojnë kohën e diagnozës. Hemokultura “Gold standard” i vendosjes së diagnozës ka sensitivitetet të ulët pasi ndikohet nga shumë faktorë dhe kërkon kohë(>72 orë).<sup>17,18</sup> Përdorimi i vetëm ose i kombinuar i testeve të tjera laboratorike, për të shkurtuar kohën e diagnozës mbetet domosdoshmëri. Në këto kushte prej vitesh janë në studim teste jo specifike citokinat dhe biomarkues të ndryshëm ku me interes dhe premtuese duket Prokalçitonina (PCT).<sup>19</sup>

Assicot et al. qenë të parët që në 1993, treguan se PCT rritet shpejt pas shpërthimit të një infeksioni bakterial dhe sepsisit dhe ka karakteristikat e proteinave të fazës akute të inflamacionit, hormoneve dhe citokinave. PCT rritet nga 2-4 orë nga çlirimi i endotoksinave, arrin pikun pas 6 orësh dhe qëndron në një përqëndrim plato nga 8-24 orë. Meta-analiza të ndryshme kanë vërtetuar rolin e saj si markues i besueshëm për vendosjen e diagnozës së sepsisit neonatal.<sup>19,20,21,22,23,24</sup> Megjithatë kërkohet një vlerësim i kujdesshëm klinik dhe i testeve laboratorike në të gjitha rastet me hemokulturë negative. Përjashtimi i diagnozës së sepsisit do të mundësojë minimizimin e përdorimit të antibiotikëve me gjithë pasojat e përmëndura më sipër.<sup>24</sup>

## RËNDËSIA

- Shkalla e sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë së sepsisit neonatal mbetet e lartë, pavarësisht përsosjes së metodave diagnostikuese, perfeksionimit të teknikave jetëshpëtuese dhe përdorimit të antibiotikëve të gjeneratave të reja. Kjo incidencë varion nga 7.7-11.5 për 1000 lindje gjallë në vendin tonë vs 5 për 1000 lindje gjallë në vendet e zhvilluara me predominim në preterm 9.8- 13.7 për 1000 lindje gjallë. Infeksioni në shërbimin tonë zë 10 % të sëmundshmërisë së përgjithshme rreth 20-30 % të vdekshmërisë. Në të porsalindurit në term vdekshmëria nga sepsisi ka qenë 26.7% , ndërsa në të porsalindurit prematurë nga 50-80 % në varësi të grupmoshës dhe grupeshës vs 30-40 % mortalitet nga sepsisi në vendet e zhvilluar.
- Përsosja e mënyrave diagnostikuese të sepsisit në periudhën e të porsalindurit, do të na ndihmojmë të ulim vdekshmërinë, por edhe të përmirësojmë nivelin e kujdesit në të porsalindurit që trajtohen me antibiotikoterapi. Duke vendosur sa më herët diagnozën reduktojmë numrin e pacientëve që trajtohen më gjatë pa qenë e nevojshme me antibiotikë, shoqëruar kjo me gjithë pasojat që e shoqërojnë.
- Është i pari studim i këtij lloji në vendin tonë.

# **KAPITULLI 1**

## **TË DHËNA MBI SEPSISIN NEONATAL DHE DIAGNOZËN E TIJ**



## 1.1. PËRKUFIZIMI I SEPSISIT NEONATAL

1.1.1. Konferenca Pediatrike Ndërkombëtare mbi Konsensusin e Sepsisit.<sup>30</sup>  
Ekspertë mbi sepsisin dhe studiues nga Kanada, Franca, Holanda, UK dhe USA modifikuan përkufizimin e adultëve të Sindromës së Përgjigjes Inflammatorë Sistemike (SIRS). Përkufizimi i Sepsisit në moshën fëmijënore dhe Neonatale është i ngjashëm me atë të adultit por parametrat si frekuenca respiratore (FR), frekuenca kardiake (FK), dhe indekset hematologjike lidhen me moshën e fëmijës.<sup>30,31</sup> Kështu:

*Sepsisi neonatal konsiderohet si një sindrom klinik i karakterizuar nga një zinxhir ngjarjesh inflamatorë dhe joinflamatorë, reaksionesh humorale dhe qelizore dhe njëkohësisht edhe ndryshimeve hemodinamike që pasojnë.*<sup>4,30,31</sup>

Psh SIRS përcaktohet si prania e 2 nga katër kriteret e mëposhtëme:

- 1) alterime të temperaturës trupore (hipo/hipertermi)
- 2) takikardi/bradikardi (alterime hemodinamike)
- 3) rritje të FR > 60/min dhe/ose apnoe
- 4) leukocitoze mbi 25 000/mm<sup>3</sup> ose leukopeni nën 5000/mm<sup>3</sup>

1.0.2. “Sepsis klinik”- nuk ka një përkufizim të përbashkët, por shumica e klinikistëve dhe studiuesve të fushës, quajnë sepsis klinik gjendjen klinike të foshnjës kur hemokultura apo kulturat e thella të tjera rezultojnë negativ, por foshnja ka klinikë evokuese për sepsis.<sup>31,32,33,34</sup>

1.0.3. “Sepsis i sigurt /i provuar”- shenja klinike evokuese për sepsis, alterime të indekseve laboratorike dhe hemokultura /ose kulturat e tjera të thella pozitive.<sup>34</sup>

1.0.4. “Sepsis i dyshimtë”-shenja klinike jo të qarta ose alterime të indekseve laboratorike.<sup>31,34</sup> Kulturat e thella negative.

## 1.2. EPIDEMIOLOGJIA E SEPSISIT NEONATAL

Sepsis neonatal është një nga shkaqet më të shpeshta të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë sidomos në vendet në zhvillim, si vendi ynë, me mundësi të kufizuara financiare dhe me një nivel jo të përshtatshëm të ofrimit të kujdesit shëndetësor sidomos antenatal. Kështu që një vendosje e hershme e diagnozës është mjaft e rëndësishme, si për të vendosur trajtimin me antibiotikët e përshtatshëm dhe në kohën e duhur, në mënyrë që të reduktohen pasojat e tij mbi shëndetin e të porsalindurit, vdekshmëria gjithashtu.<sup>24,25</sup>

Meqenëse hemokultura ka një ndjeshmëri/sensitivitet të ulët në sepsisin neonatal<sup>3</sup>, shumë foshnja me shenja klinike të sepsisit, por një hemokulturë negative, konsiderohen me sepsis. Kjo gjendje quhet sepsis klinik, ose sepsis i mundshëm apo i dyshuar<sup>4-6</sup>, por pa një përcaktim të qartë; kjo edhe pasi shenjat klinike të sepsisit neonatal janë jo specifike.<sup>7</sup>

Shpeshtësia e sepsisit neonatal varion nga 1 në 10 për 1000 lindje gjallë, por nuk ka studime të gjera dhe studimet aktuale janë të fokusuara në foshnjat me rrezik të lartë, siç janë foshnjat e lindur parakohe ose VLBË, dhe kryesisht në në vendet e zhvilluara.<sup>7-14</sup> Është edhe më e vështirë të gjenden të dhëna të sepsisit neonatal për vendet në zhvillim, por nga të dhënat e raportuara kjo shpeshtësi varion midis 2 deri 50 për 1000 lindje gjallë. Vështirësia në vendosjen në kohë të diagnozës (specifikat klinike), mungesa e mjeteve të hershme dhe të përshtatshme të diagnozës, sidomos në vendet në zhvillim, qasja e kufizuar për terapinë e duhur; bëjnë që 99% e 4 milion vdekjeve neonatale vjetore në botë, të ndodhin në vendet në zhvillim dhe 26% e këtyre vdekjeve shkaktohen nga infeksionet e rënda.<sup>15,16</sup>

Por edhe në vendet e zhvilluara megjithë sofistikimin e mjeteve diagnostikuese, përdorimin e mjeteve terapeutike nga më të përsosurat, sepsisi neonatal mbetet ende ndër shkaqet kryesore të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë neonatale.<sup>8,17,18</sup>

Roli i saktë i infeksionit në ecurinë klinike të një foshnje të sëmurë është i vështirë të përcaktohet, pasi shumë nga këto foshnja kanë edhe shumë faktorë të tjerë rreziku. Por në dy studime të mëdha amerikane dhe një studim izraelit, vdekshmëria ishte afërsisht dy deri në tre herë më e lartë për foshnjat edhe me sepsis të hershme ose të vonë. Për të dy të dy format e sepsisit (EOS, LOS), vdekshmëria është më e lartë kur patogeni (shkaktari) është gram-negativ sesa gram-pozitiv.<sup>8,18,19</sup>

Sepsis gjithashtu shoqërohet me rritje të kostove dhe një rrezik të lartë të sëmundshmërisë neonatale. Një studim i vitit 2004 nga Rrjeti i Oksfordit Vermont vlerësoi se një episod septik zgjat kohën e qëndrimit në spital me afërsisht 7 ditë me një kosto prej 10 000 dollarë amerikanë, ndërsa Chen et al.<sup>26,27</sup> raportoi një rritje të ngjashme në kohën e qëndrimit (por me një kosto më të ulët) nga një studim në Kinë. Për të shmangur këto shpenzime dhe vdekshmërinë, ka një interes në rritje për të parandaluar infeksionet neonatale, dhe ka prova që rutinat e rrepta të higjienës mund të jenë masa efektive për të parandaluar sepsisin nosocomial (LOS). Përdorimi si

profilaksi e antibiotikëve intrapartum mund të parandalojnë fillimin e hershëm të sepsisit, sidomos nga Streptokoku i Grupit B (GBS).<sup>28,29</sup>

### 1.3. KLASIFIKIMI I SEPSISIT NEONATAL

Në varësi të kohës së shfaqjes së infeksionit dhe mënyrës së transmetimit infeksionet/sepsis neonatal klasifikohet në: Sepsis i hershëm (Early Onset Sepsis-EOS) dhe Sepsis i vonë/nozokomial (Late Onset Sepsis-LOS).<sup>31,32,33,34,35,36</sup> (Tab.1)

Tabelë 1 Klasifikimi i Sepsisit Neonatal <sup>31,32,33</sup>			
Lloji i Sepsisit	Koha e shfaqjes	Transmetimi	Shkaktari
EOS	< 48-72 orë nga lindja	Vertikal	<u>Neonat në term:</u> GBS, <i>Enterococci</i> , <i>L. monocytogenes</i> <u>Neonat Preterm:</u> GBS, <i>E. coli</i> , <i>H. influenzae</i> , gram-negative bacilli
LOS	>72 orë deri 28 ditë nga lindja	Sekondar (mjedisi, manipulimet, procedurat mjekësore)	GBS, <i>S. aureus</i> , Coagulase-negative staph ( <i>S. epidermidis</i> ), <i>Serratia</i> , <i>Klebsiella</i> , <i>Pseudomonas</i> , <i>Candida species</i>

#### 1.3.1. SEPSISI I HERSHËM (EOS)

EOS normalisht konsiderohet si një transmetim vertikal i transmeuar nga nëna tek fëmija përreth (para/gjatë) lindjes. Në shumicën e EOS shkaktarë janë patogjenët e pranishëm në florën gjenitale të nënës që ngjitet në fetus përmes membranave amniotike. Faktorët e rrezikut për EOS përfshijnë:

- 1) Faktorët amtar të rrezikut:<sup>37,38</sup>
  - a. Plasje e parakohshme e membranave (PROM) > 18 h.
  - b. Aktivitet lindje > 15 orë
  - c. Infeksion urinar i pashëruar
  - d. Ethja amtare (> 38°C)
  - e. Korioamnioniti
  - f. Leukocitoza amtare > 18 000/mm<sup>3</sup>
  - g. Kolonizim anormal i vaginës (GBS, herpes etj.)
  - h. Vizita të shpeshta vaginale.

- i. *Ndërhyrje obstetrikale invazive.*
- j. *Likidi amniotik i ngjyrosur mekonial*

2) Faktorët neonatalë të rrezikut.<sup>37,38</sup>

- a) Brishtësia fiziologjike e të porsalindurit
- b) Moshë e vogël e barrës.<sup>5,6, 39</sup>
- c) Peshë në lindje. Rreziku rritet në fëmijët me peshë të vogël në lindje dhe shkon në .<sup>5,6</sup>
  - ✓ 5.99/1000 per PL<1500 gr
  - ✓ 2.51/1000 per PL 1500-2500 gr
  - ✓ 0.89/1000 per PL >2500gr

Mortaliteti në fëmijët me sepsis rritet me uljen e peshës së lindjes. Ky mortalitet është 2 herë më i lartë në foshnjat me PL<1500gr vs PL1500-2500 gr dhe 7 herë më i lartë krahasuar me PL >2500gr.

- d) Asfiksia perinatale (Apgar <6 në min. 5<sup>-të</sup>).<sup>37,38</sup>
- e) Procedura invazive (linjë venoze, kateterizim, intubim, aspirim, ushqyerje me sondë).<sup>37,38</sup>
- f) Seksi mashkull. Foshnjat meshkuj janë herë më të rrezikuar se ato femra.<sup>37,38</sup>

Shkaktari më i shpeshtë i EOS mbetet GBS në foshnjat e lindura në kohë.<sup>40</sup> Sipas udhëzimeve të Qendrës Amerikane për Kontrollin e Sëmundjeve, depistohen më tëpërvektalë gjithë shtatëzetat mbi 35 javë moshë barre (Konsensusi i 2002). Këto udhëzime kanë ulur shkallën e infeksionit nga GBS tek foshnjat në USA nga 1.7 / 1000 lindje në 1990 në 0,4 / 1000 lindje në 2005.<sup>40</sup>

### 1.3.2. SEPSISI I VONË (LOS)

LOS ose infeksioni nosocomial është një ndërlikim i kujdesit intensiv neonatal. LOS prek kryesisht foshnjat e lindur para kohe ose me peshë të ulët në lindje pas ditës së 3<sup>të</sup> të jetës dhe më shpesh pas javës së 2<sup>të</sup> të jetës me një shpeshësi deri 36% në moshat e barrës nga 26<sup>të</sup>-32<sup>të</sup>.<sup>41,42,43,44</sup>




Fig 1. Clin Microbiol Rev. 2004; 17 (3): 638-680

Faktorët e rrezikut që shoqërohen normalisht me LOS janë lindjet para kohe, peshë e ulët e lindjes, seksi mashkull, niveli i ulët i IgG në serum, ventilimi mekanik, trajtimi me dexamethasone, përdorimi i zgjatur i kateterëve intravaskular, ushqyerja parenterale dhe ushqyerja e vonuar enterale.<sup>41,43,45-48</sup> Shkaku më i zakonshëm i LOS është Stafilokoku Koagulazë Negativ (CoNS), i cili në shumë studime është gjetur si shkaktar në 50% të rasteve LOS.<sup>42</sup> Të tjerë janë Stafilokoku aureus, Streptokoku i Grupit B, Enterokoku, Escherichia coli, Klebsiella dhe Pseudomonas.<sup>45-48</sup>

## 1.4. DIAGNOZA E SEPSISIT NEONATAL

### 1.4.1. KLINIKA

Diagnoza e sepsisit neonatal mbetet e vështirë<sup>32,33,34</sup>. I porsalinduri qoftë në term apo i lindur parakohe e ka të pamundur të kufizojë “invazionin” bakterial, për shkak të papjekurisë fiziologjike të sistemit imunitar. Në këtë mënyrë infeksioni është i gjeneralizuar, në formë septicemie, me prekje multiorganore, duke bërë që klinika të jetë jospecifike.<sup>49,50,51</sup> Kjo vështirëson diagnozën..<sup>55</sup>

Sepsisi mund të manifestohet me:<sup>12,52,53,54</sup>

- i. Shenja respiratore (distress respirator, bradipnoe, apnoe).
- ii. Alterime hemodinamike (takikardi >180/min, bradikardi <80/min, hipotension arterial, perfuzion periferik i ulur, kohë rekolorimi e zgjatur > 5sek.).
- iii. Shenja gatro-intestinale (të vjella, intolerancë gastrike, ileus).
- iv. Shenja të prekjes së sistemit nervor (letargji, irritabilitet, hypotoni, konvulsione).
- v. Kontroll jo i mirë i temperaturës trupore (hipertermi >38<sup>0</sup>C, hipotermi <35.5<sup>0</sup>C).

### 1.4.2. Nuk ekziston një markues ideal, apo një test i vetëm për vendosjen e diagnozës së sepsisit neonatal.<sup>55</sup>

*Karakteristika të një testi ideal do të ishin :<sup>66</sup>*

#### 1.4.2.1. Karakteristikat klinike

- A. Sentivitet i lartë (deri 100%!!!!)
- B. Specificitet i lartë (>85%)
- C. PPV >85%
- D. NPV sa më afër 100%
- E. Të dedektojë sa më herët infeksionin
- F. Të monitorojë terapinë

#### 1.4.2.2. Karakteristika laboratorike

- A. Të jetë i qëndrueshëm, të ketë gjysmë –jetë të mjaftueshme për tu kapur dhe monitoruar në gjak (periudha dritare).
- B. Të jetë i matshëm
- C. Të kërkojë sasi minimale të kampionit për tu matur.
- D. Të matet në mënyrë sa më të thjeshtë
- E. Kohë të shkurtër për të marrë rezultatin
- F. Kosto të ulët

#### 1.4.3. Testet specifike= hemokulta “gold standard”.<sup>4,32,57</sup>

- i. Nevojitet 1-2 ml gjak i marrë në ose në kordonin umbilical, ose në katerin arterial, ose në venë periferike.
- ii. Koha e rezultatit: Rezultati merret pas 72 orësh nga marrja dhe sensitiviteti është i ulët pasi:
  - a. Mund të kontaminohet (procedurë jo korrekte e marrjes)=fals pozitiv
  - b. Sasi e pamjaftueshme gjaku (në të porsalindur sasia shpesh nuk arrihet)=fals negativ
  - c. Përdoren antibiotikë para lindjes nga nëna=fals negativ

#### 1.4.4. Testet jospecifike=Biomarkuesit e infeksionit.<sup>32,58</sup>

##### 1.4.4.1. Hematologjikë

Testet hematologjike janë të parat dhe më të përdorshmet në praktikën e përditshme nga klinikistët. Referohen sensitivitete dhe specificitete të ndryshme të këtyre markuesve.<sup>53,65,67,68</sup>

(Tabela 2)

##### 1. Numri i leukociteve (ËBC) dhe formula leukocitare.<sup>57</sup>

- a. Numri total i  $\text{ËBC} < 5000/\text{mm}^3$  dhe  $> 20000/\text{mm}^3$ .  
ËBC ka vlerë të ulët prediktive positive (PPV).  
Vlera totale e leukociteve ka një sensitivitet të ulët që varion nga 17-67%<sup>60-63</sup> në diagnozë pasi ato ndikohen nga shumë evente perinatale (induksion, asfiksia, likidi amniotik mekonial, detresi respirator etj).<sup>57,64</sup>
- b. Indekset e neutrofileve të dobishme për të përjashtuar foshnjat e painfektuara.
  - i. Numri absolut i neutrofileve ka PPV dhe sensitivitet të ulët. Ndikohen nga

induksioni, asfiksia, likidi amniotik mekonial, detresi respirator etj) <sup>61,62</sup>

- ii. Raporti: **Forma të papjekura/numri total i neutrofileve(I/T)>0.2** ka PPV të ulët , por vlerë predictive negative të lartë (NPV) deri 98%. <sup>32,34,56,59,61,62</sup>

2. **Trombocitet** (numri)PLT< 100.000/mm<sup>3</sup>.  
 PLT<100,000 /mm<sup>3(5,6)</sup>. Jo specifike në sepsisin e hershëm por vlerat e ulëta janë indikator i sepsisit të vonë. <sup>65</sup>

Tabelë 2 <sup>67</sup>

	Sensitivity (%)			Specificity (%)			PPV (%)			NPV (%)		
	S	PS	S+PS	S	PS	S+PS	S	PS	S+PS	S	PS	S+PS
Total WBC count	56.2	83.33	43.18	91.66	91.66	86.36	85.71	25	86.36	70.21	75	56.89
Total PMN count	90.62	75	86.36	72.22	72.22	79.16	74.35	47.36	79.16	89.65	89.65	81.25
Immature: PMN count	96.87	75	90.90	91.66	91.66	93.02	91.17	75	93.02	97.05	91.66	89.18
Immature: Total PMN ratio	93.75	83.33	90.90	94.44	94.44	95.23	93.75	83.33	95.23	94.44	94.44	89.47
Immature: Mature PMN ratio	53.12	41.66	50	97.22	97.22	95.65	94.44	83.33	95.65	70	83.33	61.4
Degenerative changes	78.12	58.33	72.72	94.44	94.44	94.11	92.59	77.77	94.11	82.92	87.17	73.91
Platelet count	81.25	41.66	70.45	94.44	94.44	93.93	92.85	71.42	93.93	85	82.92	72.34

PPV – Positive Predictive Value; NPV – Negative Predictive Value; S – Sepsis; PS – Probable Sepsis; S+PS – Sepsis+probable sepsis; WBC – White blood cell; PMN – Polymorphonuclear neutrophils

#### 1.4.4.2.

Proteinat e fazës akute  
 Proteina C reaktive(CRP) <sup>69,70,71</sup> = Më gjerësisht e përdorur. Rritet rreth 8 orë pas fillimit të procesit kryesisht inflamator në ndikimin e IL-6. Prodhimi i saj inicohet nga citokinat proinflamatore në hepar. Ka sensitivitet të ulët(14-68%)<sup>69</sup> në lindje dhe në të lindurit parakohe. Ka vlerë kryesisht përjashtuese në diagnozë. NPV arrin 75-99% në rastet kur persistojnë vlerat normale.<sup>63</sup> Shërben edhe për ndjekjen e terapisë.<sup>27,69,70,71</sup>

#### 1.4.4.3.

Citokinat proinflamatore = IL-6, IL-8, TNF-α IL-6 rritet shumë shpejt pas një eventit septik, ka sensitivitet të lartë, por gjysmë-jetë plazmatike të shkurtër çka e bën të pamatshme në serum për të ndjekur terapinë apo ecurinë e sëmundjes. E njëjta gjë



edhe për të tjerat që kanë më tepër interes në studime sesa në praktikën e përditshme.<sup>27,71,72</sup>


**Tabelë 3:** <sup>72</sup>

Accuracy of diagnostic tests or combinations of tests for early onset neonatal sepsis

Diagnostic test	Sensitivity (%)	Specificity (%)	PPV (%)	NPV (%)
<b>Antenatal</b>				
Amniotic TNF $\alpha$ $\geq$ 41 pg/ml <sup>6</sup>	82	79	47	95
PCR for genomic DNA in amniotic fluid <sup>45</sup>	100	100	100	100
<b>Postnatal</b>				
CRP <sup>15</sup>	60-82	93-96	95-100	75-87
CRP, FBE, gastric aspirate <sup>18</sup>	97	61	53	98
Procalcitonin <sup>2, 20</sup>	82-100	87-100	86-98	93-100
CD11b <sup>24</sup>	96-100	81-100	22-100	100
CD64 <sup>23</sup>	64-97	72-96	64-88	84-98
CD64, IL6 or CRP <sup>23</sup>	81-97	71-87	63-74	86-98
GCSF $\geq$ 200 pg/ml <sup>4, 28</sup>	95	73	40	99
Umbilical cord IL6 <sup>4, 31</sup>	87-90	93	93	93-100
IL6 <sup>4, 32</sup>	67-89	89-96	84-95	77-91
IL6 and/or CRP <sup>4, 32</sup>	93	88-96	86-95	95
IL8 <sup>4, 32</sup>	80-91	76-100	70-74	91-95
IL8 and/or CRP <sup>27</sup>	80	87	68	93
PCR for genomic DNA in blood culture <sup>44</sup>	100	100	100	100

PPV, Positive predictive value; NPV, negative predictive value; TNF $\alpha$ , tumour necrosis factor  $\alpha$ ; CRP, C reactive protein; FBE, full blood examination; GCSF, granulocyte colony stimulating factor; IL6, interleukin 6; IL8, interleukin 8; PCR, polymerase chain reaction.

#### 1.4.4.4. Prokalçitonina(PCT)



- i. Kodohet nga gjeni CALC-1 i lokalizuar në kromozomin e 11.
- ii. Shprehet në mënyrë specifike për indet (prodhuar kryesisht nga monocitet dhe hepatocitet):
  1. Rregullon nivelet e kalçiumit. PCT sintetizohet në peptide më të vegjël dhe kalcitoninë të maturuar që ruhet në granula sekretore dhe sekretohet në gjak për të rregulluar përqëndrimet e kalçiumit dhe fosforit.
  2. Në mungesë të infeksionit: Transkriptimi i gjenit CALC-1 në inde jo neuroendokrine është i suprimuar, përveç qelizave C të gjëndrës tiroide që prodhojnë pararendësin e kalcitoninës në individë të shëndetshëm dhe jo të infektuar. Gjeni CALC-1 në qelizat C të tiroides shkaktohet nga niveli i ngritur i kalçiumit, glukokortikoidi, peptidi i lidhur me gjenet kalcitoninë (CGRP), glukagoni, gastrina ose stimulimet  $\beta$ -

adregenike. Praktikisht, të gjitha PCT të formuara në qelizat C të tiroides shndërrohen në kalçitoninë në mënyrë që asnjë PCT të mos lëshohet në qarkullim. Prandaj, niveli i PCT në subjektet e shëndetshme është shumë i ulët (0.05 ng / mL) por sinteza inflamatore e PCT është e pavarur nga mekanizmat e mësipërm.<sup>75</sup>

3. Në prani të infeksionit: indet jo-neuroendokrine (indet parenkimale dhe llojet e qelizave të diferencuara) shprehin gjenin CALC-1 për të prodhuar nivele të rritura të PCT; funksioni i kësaj rritje aktualisht nuk dihet. Gjatë inflamacionit, PCT prodhohet kryesisht nga dy mekanizma alternative; rruga e drejtpërdrejtë e shkaktuar nga lipopolisakaridet (LPS) ose metabolite të tjerë toksike të çliruara nga mikrobet dhe rruga indirekte e shkaktuar nga ndërmjetësues të ndryshëm inflamatorë si IL-6, TNF- $\alpha$ , etj (Figura. 2).<sup>75</sup>




Fig.2 Fate of procalcitonin during inflammation and normal condition


Assicot et al. që në 1993 treguan për herë të parë lidhjen midis niveleve të larta të PCT dhe pacientëve më shenja të sepsisit. Në punimin e kryer në foshnja dhe fëmijë deri 12 vjeç ata gjetën se PCT nuk rritej në infeksionet virale dhe vlerat e saj uleshin ndjeshëm me fillimin e antibiotikoterapisë.<sup>76</sup>

#### 1.4.4.4.2. Kinetika e PCT në foshnja

Prej vitesh shkencëtarë dhe klinikistë të vendeve të ndryshme të botës janë përqëndruar në studimin e biomarkuesve të ndryshëm të sepsisit neonatal. PCT ka ngjallur interes për shkak të të dhënave premtuese në lidhje me një sensitivitet dhe specificitet më të lartë në diagnozën e sepsisit neonatal në raport me biomarkuesit e tjerë si CRP apo IL-6, IL-8 dhe citokinave të tjera.<sup>4,11,12</sup> Një meta-analizë e gjerë e cila vlerësoi nivelet e PCT në gjakun e kordonit umbilikal të foshnjave të dyshuara për infeksion, sugjeroi se matja e hershme PCT, mund të çojë në diagnostikimin e hershëm të sepsisit. Sensitiviteti shkonte në 78% për PCT e matur në kordonin umbilikal, ndaj 70% për PCT e matur 24-48 orë nga lindja.<sup>77</sup> Sensitiviteti arrinte në 89% kur matja bëhej brenda orës së 12<sup>te</sup> të jetës.<sup>78</sup>


- i. Në foshnjat e painfektuara, të shëndetshme, ka një rritje fiziologjike të niveleve të PCT, që ndodh nga 24-48 orët e para të jetës, ndoshta që lidhet me përshtatjen me jetën ekstrauterine.<sup>32,33,34,59,79</sup>
  1. PCT arrin pikun në orën 18-30<sup>te</sup> të jetës dhe normalizohet në orën e 42-48<sup>te</sup> të jetës.
  2. Ka gjysmë jetë plazmatike të shkurtër në gjakun periferik ~24-30 orë.<sup>32,80</sup>
- ii. Vlerat PCT nuk ndikohen nga mosha e barrës.<sup>34,59,79</sup>
- iii. Nivelet e PCT rriten shpejt ndaj endotoksinave bakteriale, brenda 3-4 orësh, për të arritur nivelet maksimale pas ~ 18-24 orësh, për të qëndruar të larta për të paktën 24-48 orë.<sup>81</sup>
- iv. Eventet jo infektive (detresi respirator, asfiksia, etj) ndikojnë më pak në rritjen e vlerave të PCT, krahasuar me biomarkuesit e tjerë.<sup>21,34,59</sup>
- v. Si cut-off për diagnozën e sepsisit përdoren vlerat nga 0.5- 2 ng/mL.<sup>79</sup>

vi. Duhet marrë parasysh vlera referencë që lidhën me moshën (orë-ditë jetë) të të porsalindurit.<sup>32,33,34,59,79</sup> (Figura 3. 4)<sup>12</sup>



**Figura 3. PCT cut-off sipas moshës së foshnjës**

**Figura 4. Kinetika e PCT në të porsalindur**



#### **1.4.4.4.3. Roli i PCT në diagnozën e hershme të sepsisit neonatal (Revië e Literaturës)**

##### **Metoda**

##### *Burimet e të dhënave*

U realizua kërkim sistematik në PubMed, Scopus, dhe në bazat e të dhënave në bibliotekën e Cochrane. Termat e përdorur për kërkim në PubMed ishin: PCT dhe sepsis neonatal ose infeksion neonatal. Termat e kërkimit që u aplikuan në Scopus dhe bibliotekën Cochrane ishin “PCT dhe sepsis” dhe “PCT” respektivisht.

##### ***Kriteret e përzgjedhjes së studimeve përfshinin:***

Studime prospektive të realizuar në të porsalindurit e rrezikuar për infeksion, apo me shenja të infeksionit, kur nevojitet fillimi i antibiotikoterapisë.

PCT duhej të ishte matur në kampionët e gjakut të të porsalindurve që sapo të dyshohej sepsis (rrezik amtar, neonatal, apo shenja që evokonin infeksion), përpara administrimit të antibiotikëve.

##### ***Kriteret e përjashtimit***

Abstraktet dhe punimet e papërfunduara.

Studimet retrospektive, studimet e realizuara në kafshë, dhe ato me të dhëna të paplota u përjashtuan nga vlerësimi.

### *Nxjerrja e të dhënave*

Të dhënat e nxjerra nga studimet e përzgjedhura i referohen llojit të projektit të studimit, madhësisë dhe karakteristikave të popullsisë në studim, numrit të pacientëve me vendosje të hershme /të vonshme të sepsisit, si dhe numrit dhe karakteristikave specifike të pacientëve në të dy grupet.

U nxorrën të dhënat specifike në lidhje me nivelin e cutoff në serum të PCT së vlerësuar, sensitivitetin/specificitetin, dhe vlera prediktive pozitive/negative e PCT për diagnozën e sepsisit neonatal.

### **Rezultatet**

#### *Procesi i përzgjedhjes së studimeve*

Kërkimi në PubMed gjeneroi 623 artikuj, nga të cilët 28 rezultuan të përshtatshëm për t'u përfshirë në këtë përmbledhje. Kërkimi i kryer në Cochrane nuk dha artikuj shtesë që plotësonin kriteret. Kërkimi në bazën e të dhënave në Scopus identifikoi një studim që plotësonte kriteret. Rezultuan gjithsej 29 artikuj të përshtatshëm për t'u përfshirë në këtë studim.<sup>5-33</sup>

#### *Cilësia metodologjike e studimeve të përfshira*

U përzgjedhën studime që kishin përdorur kriteret e njëjta dhe të standartizuara të besueshme, si për kriteret e përfshirjes në studim, ashtu edhe për diagnozën.

Në Fig.5 janë përmbledhur rezultatet e vlerësimit metodologjik për totalin e 29 studimeve të përfshira në meta-analizë.





Fig.5.Paraqitja grafike e cilësisë së metodologjisë së punimeve.

#### *Saktësia diagnostike e PCT*

Në analizën primare u përfshinë 16 studime, që përfshinin një total prej 1,959 neonatësh.

5-8,11,12,14,15

Sensitiviteti (95% CI) i PCT për diagnozën e sepsisit neonatal ishte 81% (74–87%), dhe specificiteti ishte 79% (69–87%) (Fig. 6).



*Fig.6. Vlerësimi i sensitivitetit dhe specificitetit me anë të meta-analizës për të gjitha punimet e analizuar të marra së bashku.*

Raporti i odds diagnostic (95% CI) ishte 16 (8–32), ndërsa raport-gjasat dhe negative (95% CI) ishin respektivisht 3.9(2.5–6.0) dhe 0.24(0.17–0.34). Zona nën kurbën HSROC (95% CI) për PCT ishte 0.87 (0.84–0.90) (Fig. 7). Indeksi I2 (95% CI) ishte 96% (92–99%).






Fig.7. Lidhja sensitivitet & specificitet në EOS




Fig.8. Lidhja sensitivitet & specificitet në LOS

### Sub-analizat

#### Saktësia diagnostike e PCT për diagnozën e EOS (sepsis i hershëm)

Gjashtë studime që përfshinin një total prej 780 foshnjash u përfshinë në analizën në lidhje me EOS.<sup>7,11,20,25,27,39</sup>

Sensitiviteti (95% CI) i PCT për diagnozën e EOS ishte 76% (68–82%), dhe specificiteti ishte 76% (60–87%). Raporti odds diagnostik (95% CI) ishte 10 (5–22), ndërsa raport-gjasat pozitive dhe negative (95% CI) ishin respektivisht 3.2 (1.8–5.7) dhe 0.32 (0.23–0.43). Zona nën kurbën HSROC (95% CI) për PCT ishte 0.78 (0.74–0.81) (Fig. 5). Indeksi I2 (95% CI) ishte 89% (77–100%).

#### Saktësia diagnostike e PCT për diagnozën e LOS (sepsis i vonshëm)

Pesë studime që përfshinin një total prej 535 foshnjash u përfshinë në analizën në lidhje me LOS.<sup>5,6,14,15,24</sup>

Sensitiviteti (95% CI) i PCT për diagnozën e LOS ishte 90% (73–97%), dhe specificiteti ishte 88% (72–96%). Raporti odds diagnostik (95% CI) ishte 67 (23–200), ndërsa raport-gjasat pozitive dhe negative të grumbulluar (95% CI) ishin respektivisht 7.7 (3.1–18.9) dhe 0.11 (0.04–0.31). Zona nën kurben HSROC (95% CI) për PCT ishte 0.95 (0.93–0.97) (Fig. 6). Indeksi I2 (95% CI) ishte 93% (86–99%).

### Diskutim

Zbulimi kryesor i kësaj meta-analize është fakti që PCT ka saktësi shumë të mirë diagnostike për sepsisin neonatal. Në analizën primare që përfshinte të gjitha studimet që vlerësonin PCT në neonatët me dhe pa sepsis, zona nën kurbën HSROC ishte 0.87 dhe sensitiviteti dhe specificiteti ishin respektivisht 81 dhe 79%. Zona nën kurbë për sepsisin EOS dhe LOS ishin respektivisht 0.78 dhe 0.95.

Avantazh i rëndësishëm i çdo markuesi biologjik të përdorur në neonatët e dyshuar për sepsis është identifikimi i saktë i episodeve septike që janë kultura negative dhe kërkojnë terapi me antibiotikë.

***Përfshirja e sepsisit nga diagnoza është e rëndësishme sepse numri i neonatëve të trajtuar me antibiotikë mund të minimizohet, koha e qëndrimit në spital mund të shkurtrohet; reduktim të rezistencës bakteriale multimedikamentoze që do të arrihen me avantazhet mjekësore dhe financiare që do të kompensojnë koston financiare të matjes së PCT.<sup>34</sup>***

*Në të vërtetë, studimet e fundit të randomizuara të kontrolluara (RCTs) kanë sugjeruar se algoritmet PCT-udhëzuese janë hoqëruar me një reduktim të ekspozimit dhe kohëzgjatjes së trajtimit me antibiotikë.<sup>4,35</sup>*

Por ashtu si është vërejtur me teste të tjera diagnostike, si proteina C reaktive(CRP) dhe formula leukocitare, PCT nuk mund të identifikojë saktë 100% të neonatëve septikë. Përdorimi i vlerës së cut-off të ulët të PCT në serum mund të rrisë teorikisht sensitivitetin dhe vlerën prediktive negative të këtij testi për diagnozën e sepsisit neonatal.<sup>38</sup>

Heterogjeniteti i konsiderueshëm në lidhje me përkufizimin e sepsisit neonatal të vërejtur në studime ilustron mungesën e një përkufizimi universalisht të pranueshëm të sepsisit neonatal, veçanërisht për të porsalindurit me shenja evidente për sepsis, por me kulturë negative.<sup>3</sup>

Vlera të ndryshme të cut-off të PCT të përfshira në studimet e analizuar nuk kishin përgjegjesi për një pjesë të konsiderueshme të heterogjenitetit statistikor të vërejtur.

Një tjetër burim potencial i heterogjenitetit mund të jetë, përfshirja e neonatëve prematurë në studimet e vlerësuara.

Duke marrë në konsideratë rritjen fiziologjike post-natale të përqendrimit të PCT në serum që është vërejtur në neonatët preterm të shëndetshëm, ashtu si dhe në neonatët në term të shëndetshëm, me vlerat e maksimale në 24-h e para të jetës, u kryen dy sub-analiza të limituara në studime që vlerësojnë performancën e PCT për diagnozën EOS dhe LOS.

Disa kufizime duhet të merren parasysh në interpretimin e rezultateve të kësaj metaanalize, në veçanti heterogjeniteti midis studimeve të përfshira në lidhje me karakteristikat e neonateve të rregjistruar(veçanërisht mosha postnatale), ashtu si dhe kriteret e gjera të përcaktimit të sepsisit neonatal.

Për më tepër një pjesë e konsiderueshme e neonateve të përfshirë në grupin septik kishte sepsis të mundshëm (klinik) (hemokulturë negativ), një diagnozë që haset shpesh në rutinën e praktikës klinike. PCT mund të ndihmojë në klasifikimin e këtyre pacientëve si septikë ose jo septikë. Megjithatë, nga të dhënat specifike të pamjaftueshme të raportuara në lidhje me ecurinë diagnostike të PCT në këtë nëngrupim pacientësh nuk mund të vlerësohej ndikimi i mundshëm i këtij faktori në rezultatet e këtij studimi. Së

fundmi, është e mundur që PCT të performojë ndryshe në sepsisin neonatal për shkak të patogjenëve gram-pozitive, gram-negative ose fungal.<sup>39</sup>

Prandaj, jo vetëm karakteristikat klinike të neonatëve të përfshirë, por edhe profili mikrobiologjik lokal në një NICU të caktuar ka të ngjarë të ndikojnë në vlerën e PCT në parashikimin e sepsisit neonatal.

### **Konkluzion**

Hulumtimet tregojnë se PCT në serum, e matur në kohën e dyshimit për sepsis, ka një saktësi shumë të mirë diagnostikuese për diferencimin e neonatëve me sepsis dhe atyre pa sepsis.

*Është një test diagnostik i shpejtë dhe gjysmë-jeta plazmatike e saj është e përshtatshme për diagnostikim më të hershëm në raport me markuesit e tjerë.*

Megjithatë dallimet e konsiderueshme midis studimeve të analizuara, si dhe mungesa e një përkufizimi uniform të sepsisit neonatal që mund të përdoret si një standart reference diagnostike, nuk lejon dhënien e një konkluzioni absolut.

Studime më të gjera që përdorin metodologji të përshtatshme janë të nevojshme për të provuar përdorimin e PCT si një marker diagnostik i sepsisit neonatal.

Studimet e ardhshme duhet të përqendrohen në kinetikën e PCT që mund të ofrojnë një vlerësim individual të rriskut në pacientët me sepsis të rëndë. Duke vlerësuar koston e lartë të matjeve të përditshme të PCT dhe vlerën më të mirë predictive negative, sugjerohet aplikimi i modeleve ku PCT të përdoret për vendosjen e diagnozës së sepsisit dhe jo për ndjekjen e ecurisë së tij.

#### 1.4.4.4. Mënyrat/ Metodatat e matjes së PCT

Vlerësimi i PCT mund të jetë sasior (quantitative) dhe gjysmë-sasior (semi-quantitative).<sup>82</sup>

3. **Teste Sasiore:** luminescence immunoassay-test (rezultati do disa orë).

- Ka 3 teste sasimore të PCT të miratuara nga FDA, rezultatet e të cilave duhen interpretuar të lidhura edhe me shenjat klinike dhe faktorët e rrezikut.
- Sasia e plazmës/serumit të përdorur 20-50 $\mu$ l<sup>32,33,34,59</sup>.
- Saktësia dedektimit e lartë: 0.1-0.3 ng/ml
- Kosto e lartë
- Sensitiviteti i metodës : 98.7%

4. **Testet gjysmë sasimore:** test i shpejtë me strips rapid test strips pranë shtratit të pacientit (rezultati në < 30 minuta).

Ka variante të ndryshme në USA, Europë.

- Realizohen me gjak, plazëm ose serum.
- Rezultati i shpejtë më pak se 30 min.
- I lehtë për tu përdorur.
- Kosto e ulët.
- Sensitiviteti i metodës: 98%

Ka pak punime të botuar, të kryera, për të krahasuar sensitivitetin e dy metodave të matjes së PCT. Testi gjysmë-sasior BRAHMS PCT-Q test dhe ai sasior LUMItest u krahasuan me indeksin Kappa të Cohen për konkordancën mes tyre. Konkordanca mes dy metodave arriti 88%. Vlera e Kappa-s rezultoi 0.235, tregues i kënaqshëm mes dy metodave.<sup>84,85</sup> BRAHMS PCT-Q test tregon konkordancë të kënaqshme me metodën sasimore dhe ndërkohë është më i shpejtë, realizohet më lehtë, ka kosto më të ulët, ndaj rekomandohet përdorimi i testeve gjysmë-sasimore në ato vende me mundësi të kufizuara ekonomike apo pamundësi teknike për të realizuar testet sasimore për PCT.<sup>83</sup>

*Në pjesëm më të madhe janë të kryera nga kompanitë prodhuese të testeve të cilat vlerësojnë sensitivitetet krahasimisht të njëjtë mes dy metodave, asaj sasimore dhe gjysmë-sasimore. Por në këtë rast mbetet konflikti i interesit.*

## **KAPITULLI 2**

### **PARAQITJA E STUDIMIT**

## 2.1. QËLLIMI E OBJEKTIVAT

### 2.1.1. QËLLIMI I STUDIMIT

*Ky studim, duke iu bashkuar studimeve të ngjashme në qendra të tjera jashtë vendit, mendojmë se do të pasurojë njohuritë në drejtim të vendosjes sa më të hershme të diagnozës së sepsisit neonatal, duke përdorur teste me sensitivitet dhe specificitet të lartë si Procalcitonina (PCT). Në këtë mënyrë trajtimi i të porsalindurve të dyshuar për infeksion do të jetë sa më i hershëm, i përshtatshëm dhe i sigurt duke përmirësuar kështu prognozën e këtyre pacientëve dhe duke ndihmuar njëkohësisht në reduktimin e përdorimit të pa nevojshëm të antibiotikoterapisë me gjithë pasojat e saj.*

## **2.1.2. OBJEKTIVAT E STUDIMI**

### **OBJEKTIVI KRYESOR**

1. Vlerësimi i efektshmërisë së përdorimit të PCT për vendosjen e hershme të diagnozës së sepsisit neonatal në të porsalindurit e dyshuar për infeksion, të lindur parakohe < 37 javë apo në kohë >37 javë, me karakteristika të ngjashme perinatale.

### **OBJEKTIVAT SPECIFIKË**

2. Përcaktimi i sensitivitetit dhe specificitetit të PCT-Q kit në diagnozën e hershme të sepsisit neonatal.(metoda gjysmë-sasiore=cilësore PCT-Q )
3. Evidentimi i rolit prediktiv negativ(NPV) të PCT në përjashtimin e diagnozës së sepsisit neonatal në Grupin PCT
4. Vlerësimi i kohës së vendosjes së diagnozës në të grupet e marra në studim(Grupi PCT=studimi dhe Grupi i Kontrollit)
5. Ditëpërdorimi i antibiotikoterapisë në të dy grupet e marra në studim.
6. Nevoja për rifillim të antibiotikoterapisë 72 nga ndërprerja e saj sipas kritereve të vendosura.
7. Ditëqëndrimi në Terapinë e Kujdesit Neonatal (NICU) për të dy grupet e marra në studim.
8. Krahasimi midis grupit të ndjekur me PCT dhe atij sipas protokollit standart për diagnozën e sepsisit neonatal për:
9. Vlerësimi i kostoeftektivitetit.

#### **Kontributet specifike që sjell projekti në njohuritë e deritanishme në vendin tonë:**

- ✓ U bashkohet testeve që përdoren për diagnozën e infeksioneve në të porsalindur, në shërbimet e Neonatologjisë, në vendin tonë.
- ✓ Sjell të reja shkencore në lidhje me diagnozën e sepsisit neonatal në vendin tonë duke përmirësuar mundësitë diagnostikuese për sepsisin nisur edhe nga rëndësia që ka zgjidhja e këtij problemi, por edhe mundësitë e kufizuara për vendin tonë.
- ✓ Plotëson arkivën e të dhënave mbi diagnozën e sepsisit, për PCT.

## **2.2. MATERIALI DHE METODA**

### **Lloji i studimit**

Studim prospektiv i randomizuar.

### **Periudha kohore**

U krye gjatë periudhës Janar 2011- Dhjetor 2014.

### **Institucioni ku u krye studimi**

Studimi u krye në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni” në Tiranë. Ky spital është njëra nga dy qendrat e nivelit të tretë të Kujdesit Neonatal.

Kitet PCT-Q Kit BRAHMS, të përdorura për studimin u siguruan privatisht, në pamundësi të sigurimit nga institucioni .

Në ngritëm hipotezën; nisur nga vlerës së lartë prediktive negative(NPV) që referohet të ketë PCT, se do të shkurtohej koha e përcaktimit të diagnozës së sepsisit, duke shërbyer si një ndihmës në marrjen e vendimit të ndërprerjes së antibiotikoterapisë para ardhjes së përgjigjes së hemokulturës , që është protokolli standart i klinikës. Gjithashtu ngritëm hipotezën se ky vendim nuk vinte në rrezik jetën e pacientit.

#### **2.2.1. Karakteristikat e popullatës së përfshirë në studim**

Gjatë periudhës Janar 2011-Dhjetor 2014 në Spitalin Universitar Obstetrik-Gjinekologjik (SOUGJ) “Koço Gliozheni” në Tiranë, lindën 18043 bebe gjallë. Në NICU u hospitalizuan 2252 të porsalindur për problematika të ndryshme: prematuritet/SMH, risk infektiv, çrregullime metabolike, hiperbilirubinemi, konvulsione, keqformime të lindura etj. U ndoqën dhe studiuuan rastet klinike të 374 foshnjave me moshë barre (MB) >32 javë, të shtruar në NICU dhe të dyshuar për infeksion neonatal. Të dhënat e përfshira në studim janë pjesë e databazës së (SOUGJ) “Koço Gliozheni” në Tiranë.



## **Kriteret e studimit**

Studimi ka qenë i randomizuar dhe jo i verbër. Stafi ishte në dijeni të testit të ri diagnostikues. Stafi është trajnuar për leximin/vlerësimin e rezultatit të testit të ri diagnostikues PCT-Q Kit BRAHMS.

### **► Kriteret e përfshirjes**

- ▣ Të porsalindurit me MB >32 javë të lindur në (SOUGJ) “Koço Gliozheni” Tiranë që dyshohen për infeksion (të dhëna klinike që çojnë në dyshim për sepsis neonatal) në prani ose jo të faktorëve amtar të rrezikut
- ▣ Të gjithë të porsalindurit që kërkojnë fillimin e antibiotikoterapisë empirike.

### **► Kriteret Përfshirjes**

- ▣ Të lindurit në qendra të tjera dhe/ose të rikthyer
- ▣ Të lindurit me nomalitë genetike/ keqformime
- ▣ Një pacient nuk përfshihet 2 herë në studim

Në total u përzgjedhën 340 foshnja me MB > 32 javë të cilët u konsideruan me faktorë rreziku për infeksion apo u gjykua e nevojshme fillimi i antibiotikoterapisë empirike për shkak të dyshimit të fort klinik për infeksion.

Gjithashtu mor edhe miratimi nga prindërit për përfshirjen në studim.

## 2.2.2. Mbledhja e të dhënave

Në bazë të kriterëve të studimit u bë vlerësimi i rasteve klinike dhe u ndërtua një databazë me të dhënat e siguruara rast pas rasti.

### 2.2.2.1. Të dhënat anamnestike

Të dhënat anamnestike u mblodhën nga kartelat obstetrikale dhe neonatale. Karakteristikat në lindje ishin: MB, Apgari I-V, gjinia, mënyra e lindje, faktorë amtar të rrezikut, antibiotikoterapi para lindjes(nëna).

### 2.2.2.2. Përcaktimi i protokollit i grupet e marra në studim/ndjekja


Pacientët u ndanë në dy grupe:

- ❑ **Grupi i studimit** (PCT) Krahas testeve standarte realizohet edhe PCT para fillimit të antibiotikoterapisë dhe pas 48 trajtimi. **(cut-off <2 ng/ml)**.  
U ndërpre antibiotikoterapia pas 2 vlerave të njëpasnjëshme të PCT negative.
- ❑ **Grupi i kontrollit** në të cilin diagnoza vendoset sipas protokollit aktual të klinikës. Trajtimi u ndërpre pas një vlerësimi klinik dhe pas marrjes së rezultatit të hemokulturës.

Pacientët e të dyja grupeve u monitoruan nga ana klinike për 72 orë nga ndërprerja e mjekimit dhe u morrën ekzaminimet hemogramë, PCR, Shkopinj, indeksi I/T.


PROTOKOLLI për DIAGNOZËN në Grupin e STUDIMIT

**Vlerwsimi i tw lindurve < 35j dhe/ose  
me klinikw pwr sepsis dhe/ose  
Asimptomatik  
me >1 Faktor Risku per Sepsis**



PROTOKOLLI për DIAGNOZËN në Grupin e KONTROLLIT

**Vlerwsimi i tw lindurve < 35j dhe/ose  
me klinikw pwr sepsis dhe/ose Asimptomatik  
me >1 Faktor Risku per Sepsis**



### 2.2.2.3. Diagnoza e sepsisit neonatal dhe klasifikimi i formave klinike

Tek të gjithë pacientët e dyshuar për infeksion , diagnoza u vendos sipas kriterëve të mëposhtëme.

**Tabela 5 Kriteret e diagnozës**

<b>S4 (Jo sepsis)</b>	Prania e <b>një prej të dhënave</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Faktor amtar/perinatal rreziku *, ose</li> <li>➤ Shenja klinike që flasin për sepsis *, ose</li> <li>➤ Vlera jo normale të ekzaminimeve laboratorike*.</li> </ul>
<b>S3(Sepsis i dyshimtë)</b>	Prania e <b>dy prej të dhënave</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Faktor amtar/perinatal rreziku *,dhe/ ose</li> <li>➤ Shenja klinike që flasin për sepsis *,dhe/ ose</li> <li>➤ Vlera jo normale të ekzaminimeve laboratorike*.</li> </ul>
<b>S2(Sepsis klinik)</b>	Prania e <b>tre prej të dhënave</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Faktor amtar/perinatal rreziku *,dhe/ ose</li> <li>➤ Shenja klinike që flasin për sepsis *,dhe/ ose</li> <li>➤ Vlera jo normale të ekzaminimeve laboratorike*.</li> </ul>
<b>S1 (Sepsis i sigurt)</b>	≥1 e dhënë (Faktor amtar/perinatal rreziku,Shenja klinike që flasin për sepsis,Vlera jo normale të ekzaminimeve laboratorike. <b>DHE Hemokultura POZITIVE</b>

\* shih tabelën 6

**Tabela 6**



<b>Faktor amtar/perinatal rreziku</b>	Nëna Strep.grup B pozitiv PROM>18 h Korioamnionitis(temp.>38.5 <sup>0</sup> C, takikardi fetale) Lindje <35 jave IVU të patrajtuar 2 javët e fundit
<b>Shenja klinike që flasin për sepsis</b>	Sistemi respirator(DR/apnoe) Takikardi /bradikardi Hipotension /perfuzion periferik i ulur Hypotermi/hipertermi Konvulsione /hipotoni/irritabilitet/letargji/probleme në ushqyerje Të vjella/intolerancë gastrike
Vlera jonormale të ekzaminimeve laboratorike	ËBC <5000 /mm <sup>3</sup> ose >20000 /mm <sup>3</sup> (5), I/T >0,2 PLT<100,000 /mm <sup>3</sup> (5,6)

#### 2.2.2.4. Dozimi i PCT

Për vlerësimin e PCT u përdor dozimi gjysmë-sasior i PCT, me anë të PCT-Q Kit B.R.A.H.M.S. U përdor ky kit për shkak të vlerës (kostos) efektive edhe pasi edhe sensitiviteti i këtij testi në raport me atë sasior shkon 90-92%, dhe NPV në raport me atë sasiore shkon 96-98%.<sup>83-85</sup>

- ✓ Koha e realizimit: Testi u realizua rreth 2 orë nga lindja, dhe orën e 48<sup>të</sup> të jetës.
- ✓ Nevojitet 200µl serum në temperaturën e dhomës.
- ✓ Rezultati: Inkubacioni 30 minuta.
- ✓ Vlerësimi i testit (rezultati) u bë nga një person staf mjekësor që nuk kishte lidhje me studimin.


#### *PCT në neonatë*



- Në neonatë vlerat PCT janë fiziologjikisht dhe në lidhje me moshën e tyre në rritje. Një kulm është arritur në 24 h (2 ng / ml 20 ng / ml).
- Në sepsisin me fillim të hershëm PCT ofron një diferencim të qartë midis neonatëve të infektuar nga të painfektuarit në 2 ditët e para të jetës
- Pas 2 ditësh të zbatohen vlerat normale për fëmijët dhe të rriturit .

Table 3 PCT reference ranges for neonates of 0 – 48 hours of age (including 95% of all measurements)

Age in hours	PCT [ng/mL]
0–6	2
6–12	8
12–18	15
18–30	21
30–36	15
36–42	8
42–48	2



### 2.2.2.5. Klasifikimi i foshnjave sipas grupmoshave

Të porsalindurit për secilin grup të marrë në studim (PCT apo kontrolli) u klasifikuan në nëngrupe  $\geq 32$  javë &  $\leq 34$  javë; grupi  $>34$  javë.

### 2.2.2.6. Randomizimi

Të porsalindurit iu vu një numër dhe në mënyrë të randomizuar (duke përdorur zarfe me shenjë) u ndanë në grupin e studimit A (PCT) dhe grupin B (I kontrollit).

### 2.2.2.7. Treguesit klinikë dhe variablat e studimit

Të gjithë foshnjat e përfshira në studim, e të dy grupeve u monitoruan për shenjat klinike të infeksionit si distres respirator, apnoe, instabilitet i temperaturës, hypotension arterial, taki/bradikardi, intolerancë gastrike, irritabilitet, konvulsione, hipotoni. U monitoruan dhe vlerësuan ekzaminimet hematologjike sipas protokolleve përkatëse.

### 2.2.2.8. Ndërprerja e antibiotikoterapisë

Në grupin e studimit u ndërpre antibiotikoterapia kur foshnja klinikisht stabilë dhe dy vlera të njëpasnjëshme të PCT  $< 2$  ng/ml pas 48 orësh.

Në grupin e kontrollit u ndërpre antibiotikoterapia kur foshnja klinikisht stabilë dhe rezultati i hemokulturës =steril pas 3-5 ditës.

### 2.2.2.9. Dështimi i protokollit PCT (rifillimi i antibiotikoterapisë brenda 72 orësh nga ndërprerja & mortaliteti )

U konsiderua si dështim i protokollit nevoja për të rifilluar antibiotikoterapinë, për shkak të shfaqjes së shenjave klinike të sepsisit tëk foshnjat, brenda 72 orësh nga ndërprerja e mjekimit. U vlerësua edhe vdekshmëria në të grupet.

#### **2.2.2.10. Komplanca e stafit**

Shumica e stafit e vlerësoi studimin si një mundësi për të përmirësuar praktikat klinike. Çdo anëtari të stafit iu bënë të disponueshme të rekomandimet e bazuara në evidencë si dhe shpjegime të detajuara. Pas instruktimit/familjarizimit me leximin e rezultatit të testit, stafi infermjeror u përfshi në vlerësim të rezultatit.

### **2.3. ANALIZA STATISTIKOR**

#### **2.3.1. Variablat e interes**

- Mosha e barrës (MB): variabël i vazhdueshëm
- Pesha në lindje(gramë): variabël i vazhdueshëm
- Apgar min.I: variabël i vazhdueshëm
- Apgar min.V: variabël i vazhdueshëm
- Gjinia e foshnjë: variabël kategorik, Mashkull/Femër
- Mënyra e lindjes: variabël kategorik, Lindje normale/ Sectio cesarean
- Induksion i lindjes: variabël kategorik dikotomik, Po/Jo
- Faktorë amtar rreziku: variabël kategorik dikotomik, Po/Jo
- PROM>18 h: variabël kategorik dikotomik, Po/Jo
- Chorioamnionitis: variabël kategorik dikotomik, Po/Jo
- Antibiotikë intrapartum: variabël kategorik dikotomik, Po/Jo
- Indekse hematologjike(ËBC, PLT, CRP): variabël i vazhdueshëm
- PCT, I/T>0.2: variabël kategorik dikotomik, Po/Jo
- Dita e vendosjes së diagnozës: variabël i vazhdueshëm
- Ditëpërdorimi antibiotikësh: variabël i vazhdueshëm
- Ditëqëndrimi në NICU: variabël i vazhdueshëm
- Rifillimi i antibiotikoterapisë Brenda 72 h nga ndërprerja: variabël kategorik dikotomik, Po/Jo

#### **2.3.2. Analiza statistikore**

Të dhënat e vazhdueshme si: MB, pasha, Apgari I, Apgari V, ditëqëndrimet, indekse hematologjike etj u shprehën në vlera mesatare me deviacion standart (DS). Ato u krahasuan duke përdorur Mann-Whitney U test.

Të dhënat kategorike si, gjinia, mënyra e lindjes, vdekshmëria etj.; u paraqitën në vlerë absolute dhe përqindje. Proporcionet u krahasuan duke përdorur Fisher exact test.

Për të vlerësuar ndryshimet mes ditëpërdorimit të antibiotiko-terapisë u vlerësua reduktimi i rrishtit absolut ARR dhe u llogarit OR për interval koifidence CI 95%.. Të gjitha testet u realizuan për toë-side dhe vlera të  $p < 0.05$  u vlerësuan domethënëse.

## **KAPITULLI 3**

## **REZULTATET E STUDIMIT**



### **3.1. REZULTATET**

- ❑ Studimi u krye në SUOGJ “Koço Gliozheni” Tiranë, ku ka Shërbim të Obstetrikës dhe Patologjisë së Shtatzënisë si dhe Terapi Intensive Neonatale (NICU) të nivelit të tretë.
- ❑ Studimi u krye gjatë periudhës Janar 2011-Dhjetor 2014.
- ❑ Gjatë kësaj periudhe lindën 18.043 foshnja gjallë.
- ❑ Në NICU u hospitalizuan 2252 të porsalindur me problematika të ndryshme: prematuritet/SMH, rrisht infektiv, sepsis, çrregullime metabolike, hiperbilirubinemi, konvulsione, keqformime të lindura etj.
- ❑ Në studim u përfshinë 374 të porsalindur me moshë barre >32 javë të dyshuar për infeksion, në prani të faktorëve të rrezikut (PROM>18h, temperaturë amtare >38 °C, IVU e patrajtuar, Chorioamnionit etj) dhe/ose në prani të shenjave klinike për sepsis neonator të hershëm, kur u nevojiti fillimi i antibiotikoterapisë empirike.

- ❑ U përjashtuan nga studimi 34 raste të cilat rezultuan me moszbatim korrekt të protokollit në vendosjen e diagnozës, ose u diagnostikuan për keqformime të lindura pas ditës së dytë të lindjes.
- ❑ 340 pacientët e mbetur u randomizuan në dy grupe sipas kriterëve të studimit: Grupi i Studimit (PCT) me 153 pacientë dhe Grupi i kontrollit me 187 pacientë ku u zbatua protokollin standart i klinikës për diagnostikimin dhe trajtimin e sepsisit neonatal.
- ❑ Në fund të periudhës së studimit 30 foshnja nga 340 të dyshuara për sepsis neonator, patën rezultat të pafavorshëm (vdekje neonatale) pas diagnostikimit dhe trajtimit për sepsis neonator.
- ❑ Mortaliteti nga sepsisi neonatal rezulton 8.82 %

### 3.1.1. Roli i EOS & LOS në sëmundshmërinë në NICU dhe në Vdekshmëri

**TABELA 1. Shpeshtësia e EOS & LOS gjatë periudhës së studimit**

	2011		2012		2013		2014	
	EOS	LOS	EOS	LOS	EOS	LOS	EOS	LOS
/1000 lindje gjallë	6.75	<b>2.26</b>	4.68	3.1	5.26	6.1	3.2	7.2
% në NICU	5.04	1	3.96	2.6	3.96	4.46	2.4	5.3
Vd sepsis (%)	7.69	11.7	14.2	14.2	7.6	15.38	10.4	8.3
Vd Sepsis/Vd total (%)	<b><u>33.2 %</u></b>		<b><u>24.39%</u></b>		<b><u>41.37%</u></b>		<b><u>20%</u></b>	


**Koment Tabela 1:** Në tabelën e mësipërme përcaktohet shpeshtësia e EOS dhe LOS për periudhën e studimit. Rezulton së:

- 1-Sepsisi Neonatal përbën rreth 10 % të sëmundshmërisë në NICU.
- 2-Shpeshtësia e LOS është rritur ndër vite.
- 3-Vdekshmëria në EOS shkon deri 14%.

4- Vdekshmëria në LOS shkon deri 15.5%.

5- Vdekshmëria nga Sepsisi Neonatal varion nga 20-40 % gjatë periudhës së studimit.

**GRAFIKU 1. EOS vs LOS**



**Koment Grafiku 1:** Ka rritje të shpeshtësisë të LOS deri 2-fish të EOS. Pra ka ndryshim në tipologjinë e semundshmërisë.

### 3.1.2. Krahasimi i grupeve sipas të dhënave që u morën në analizë

	Grupi PCT(N=153)	Grupi i kontrollit(N =187 )	P<0.5
<b>MB</b>	<b>33.7±2.64</b>	<b>33.8±2.69</b>	<b>p=0.19</b>
<b>Pesha në lindje</b>	<b>2061.57±86.6</b>	<b>2100±73.8</b>	<b>P=0.43</b>
<b>Apgar</b>			
Min. I	<b>7.38±1.63</b>	<b>7.45±1.63</b>	<b>P=0.23</b>
Min. V	<b>8.53±1.06</b>	<b>8.6±1.04</b>	<b>P=0.08</b>
<b>Mënyra e lindjes(%)</b>			
Vaginale spontane	53.8	57.7	<b>p=0.14</b>
S/C	46.4	42.3	<b>p=0.04</b>
induksion	15.6	<b>37.4</b>	<b>p&lt;0.001</b>
<b>Sexi (%)</b>			
Meshkuj	<b>59.5</b>	<b>37.9</b>	<b>p=0.02</b>
Femra	<b>40.5</b>	62.1	<b>p=0.022</b>
<b>Pa faktor amtar rreziku (%)</b>	52.9	35.2	<b>P=0.001</b>
<b>PROM&gt;18 h</b>	<b>37.2</b>	<b>48.6</b>	<b>P=0.03</b>
<b>Korioamnionit</b>	<b>4.5</b>	<b>6.4</b>	<b>p=0.46</b>


Antiotikë intrapartum (%)	18.9	19.2	p=0.2
Antibiotikë& faktorë rreziku(%)	91.8	98.1	P=0.056

**TABELA 2. KARAKTERISTIKAT E PËRBASHKËTA & FAKTORËT E RREZIKUT**

**Shënim:** Të dhënat janë shprehur në përqindje, mesatare ± deviacion standart(DS)  
Vlera e p u llogarit sipas Mann-Ëhitney U test (p<0.05) është ndryshim sinjifikativ.

**Koment Tabela 2.** Të dy grupet rezultuan: të barabartë për moshën e barrës, peshën në lindje, Apgari I-V, menyrës së lindjes vaginale, dhe antibiotikoterapisë intrapartum në parani të faktorëve të rrezikut, pa diferencë sinjifikative nga ana statistikore p>0.05. Rezultuan të pabarabartë në fakt në faktorët amtar të rriskut, në grupingrupin e kontrollit pati më shumë induksion të lindjes dhe grupet ishin të pabarabarta përsa i takon gjinisë, ku p<0.05.

### 3.1.3. Antibiotikoterapi empirike në rastet e dyshuara për infeksion



**GRAFIKU 2.** Antibiotikoterapi empirike në rastet e dyshuara për infeksion.

**Koment Grafiku 2.** Vetëm 36 % e rasteve të dyshuara për infeksion rezultuan me sepsis neonatal. Kështu që 64 % e të dyshuarve për infeksion i nënshtrohen një

antibiotikoterapie të panevojshme duke rritur rezistencat mikrobike dhe duke i ekspozuar këto foshnja

### 3.1.4. SHPESHTËSIA E SEPSIST NEONATAL NË TË DY GRUPET

**TABELA 3. Sepsisi neonatal në të dy grupet**

	Grupi PCT(N=153)	Grupi i kontrollit(N =187 )	P<0.5
<b>S1+S2</b>	<b>6.5 %</b>	<b>14.4 %</b>	<b>p=0.01</b>
<b>S3</b>	<b>55.5%</b>	<b>51.3%</b>	<b>p=0.5</b>
<b>S4</b>	<b>37.9%</b>	<b>34.2</b>	<b>p=0.4</b>

***Koment Tabela 3.** U gjetën diferenca statistikisht domethënëse mes dy grupeve të marra në studim, për sa i takon shpeshhtësisë së Sepsisit Neonatal ( $p<0.05$ ). Ndërsa të dy grupet janë të barabarta për format S3& S4 ( sepsis i dyshimtë dhe Jo sepsis) të dy grupet rezultuan pa ndryshime ( $p>0.05$ ).*

### 3.1.5. Përse më shumë sepsis në grupin e kontrollit

**TABELA 5. FAKTORËT E RREZIKUT & SEPSISI**

	Grupi PCT	Grupi Kontrollit	OR CI95%	RR CI95%	P<0.05
<b>Pa faktor amtar rreziku</b>	81/153	66/187	2.06(1.3-3.1)	1.5(1.1-1.9)	<b>0.001</b>
<b>PPROM&gt;18h</b>	57/153	91/187	0.62(0.4-0.96)	0.76(0.59-0.98)	<b>0.03</b>
<b>Antib. intrapartum</b>	29/56	36/106	2(1.07-4.04)	1.5(1.05-2.19)	<b>0.02</b>
<b>Induksioni</b>	24/153	70/187	0.3(0.18-0.5)	0.4(0.2-0.6)	<b>&lt;.0001</b>

<b>Induksioni/Koha e lindjes(dite)</b>	4.3±1.1	5.02±2.6 <u>0.9(0.46-1.34)</u>			<b>0.03</b>
<b>S1+S2</b>	10/153	27/187	0.4(0.19-0.08)	0.45(0.22-0.9)	<b>0.01</b>

**Koment Tabela 4.** Prania e më shumë faktorëve të rrezikut perinatal në grupin e kontrollit, prania e më shumë rasteve me induksion, latenca më e zgjatur në këtë grup, bën që incidenca e sepsisit në këtë grup të jetë më e lartë dhe ndryshimi të jetë sinjifikativ  $p < 0.05$ . Ndoshta në vlera mund të ketë ndërhyrë edhe numri jo i barabartë i dy grupeve (153/187)

### 3.1.6. Vlera e testeve diagnostike në diagnozë

U vlerësua sensitiviteti, specificiteti, PPV, dhe NPV për gjithë testet e përdorur në orën e 12-të të jetës. (shih tabelën 6)

**TABELA 6: Vlerësimi i testeve diagnostike në orën 12<sup>-të</sup> të jetës**

<i>Testi diagnostik</i>	<i>Sensitiviteti</i>	<i>Specificiteti</i>	<i>PPV( %)</i>	<i>NPV (%)</i>
	%	%		
<b>PCT</b>	<b>90.9</b>	<b>89.3</b>	<b>76.9</b>	<b>96.15</b>
<b>CRP</b>	<b>54.54</b>	<b>53.5</b>	<b>31.37</b>	<b>75</b>
<b>Leukocite</b>	<b>38.8</b>	<b>89.28</b>	<b>40</b>	<b>73.5</b>
<b>I/T</b>	<b>27.78</b>	<b>60.71</b>	<b>21.4</b>	<b>68</b>

<b>Shkopinj</b>	<b>45.5</b>	<b>67.85</b>	<b>35.7</b>	<b>76</b>
<b>PLT</b>	<b>52.7</b>	<b>67.85</b>	<b>47</b>	<b>86.3</b>
<b>Hemokultura</b>	<b>47.27</b>	<b>85.7</b>	<b>42.8</b>	<b>75</b>

**Koment Tabela 6.** Testet e përdorura rutinë në praktikën klinike rezultuan me sensitivitet dhe PPV të ulët. Hemokultura e përdorur si “Gold Standard” rezultoi me sensitivitet 47.27%. PCT testi i përdorur në grupin e Studimit (PCT) rezultoi me sensitivitet dhe NPV të lartë. Kjo mund të ndihmojë si në vendosjen e hershme të diagnozës së sepsisit ashtu edhe në “Rul out” të sepsisit neonatal.

## TABELA 7. Vlerësimi i testeve diagnostike në orën 36<sup>-të</sup> të jetës

*Koment Tabela 7. Testet e përdorura rutinë në praktikën klinike (ËBC, I/T, PLT) në orën e 36<sup>-të</sup> rezultuan me sensitivitetet dhe specifikitetet më të lartë. PCT testi i përdorur në grupin e Studimit (PCT), i realizuar orën e 48<sup>-të</sup> të jetës, përsëri rezultoi me sensitivitetet dhe NPV të lartë.*

<b>Testi diagnostik</b>	<b>Sensitiviteti %</b>	<b>Specifikiteti %</b>	<b>PPV %</b>	<b>NPV %</b>
<b>PCT (t48)</b>	<b>90.9 CI(0.54-0.99)</b>	<b>98.9CI (0.95-0.99)</b>	<b>89 CI(0.54-0.99)</b>	<b>99.15 CI(0.95-0.99)</b>
<b>PCR</b>	<b>54.5</b>	<b>96.4</b>	<b>31.37</b>	<b>75</b>
<b>Leukocyte</b>	<b>59</b>	<b>92.8</b>	<b>40</b>	<b>72.9</b>
<b>I/T&gt;0.2</b>	<b>27.27</b>	<b>89.82</b>	<b>60</b>	<b>76.47</b>
<b>Shkopinj &gt;10%</b>	<b>54.54</b>	<b>45.67</b>	<b>66.6</b>	<b>83.83</b>
<b>PLT</b>	<b>63.7</b>	<b>75</b>	<b>50</b>	<b>84</b>
<b>Hemokultura</b>	<b>47.27</b>	<b>85.7</b>	<b>42.8</b>	<b>75</b>

### 3.1.7. Vlerësimi i ekzaminimeve standarte hematologjike midis dy grupeve

Grupet u krahasuan për të gjitha testet hematologjike të përdorura për diagnozë.



**TABELA 8. Teste laboratorike dhe mundësia e diagnozës**

	Grupi PCT	Grupi i kontrollit	p<0.05
Leukocite ora 12 <sup>të</sup> (10 <sup>3</sup> ) mesatarja/range	16.9(4.9-41)	17.6(3.1-3.5)	0.9
Leukocite ora 36 <sup>të</sup> (10 <sup>3</sup> ) mesatarja/range	17.1(6.1-35)	15.9 (4.5-41.7)	0.13
I/T >0.2 ora 12 <sup>të</sup> (%)	63	40	0.02
I/T >0.2 36h	43	40	0.24
Shkopinj >10% ora 12 <sup>të</sup> (%)	63	40	0.02
Shkopinj >10% ora 36 <sup>të</sup> (%)	21	20	0.16
PLT ora 12 <sup>të</sup> (10 <sup>3</sup> ) mesatarja/range	235(89-473)	243(102-385)	0.23
PLT ora 36 <sup>të</sup> (10 <sup>3</sup> ) mesatarja/range	247(94-487)	262(103-384)	0.16
CRP (poz) ora 12 <sup>të</sup> (%)	68/153	126/187	0.002
CRP (poz) ora 12 <sup>të</sup> (%)	69/153	113/187	0.003
S1+S2	10/153	27/187	p=0.01
S3	85/153	96/187	p=0.5
S4	58/153	64/187	p=0.4

**Koment Tabela 8.** Grupet u krahasuan për të gjitha testet hematologjike të përdorura dhe rezultuan pa ndryshime sinjifikante për nr e leukociteve dhe trombociteve. Ndërsa për sa i takon indeksit I/T, shkopinjeve dhe PCR ndryshimi ishte sinjifikativ(p<0.05)

### 3.1.8. Koha e vendosjes së diagnozës

U analizua koha e vendosjes së diagnozës së sepsisit neonatal në pacientët e të dy grupeve për intervalin e koifidencës CI 95%.

**TABELA 9** **Dita e diagnozës**

	Grupi i PCT	Grupi i kontrollit	CI 95%	P<0.05
<b>S1+S2(ditë)</b>	<b>2.6±0.7</b>	<b>2.77±0.4</b>	<b>0.17(0.05-0.29)</b>	<b>0.39</b>
<b>S3</b>	<b>2.9±0.19</b>	<b>4.25±0.28</b>	<b>1.35(1.3-1.4)</b>	<b>.0001</b>
<b>S4</b>	<b>2.36±0.13</b>	<b>4.2±0.2</b>	<b>1.84(1.8-2.88)</b>	<b>&lt;0001</b>

**Koment Tabela 9.** Nga përpunimi dhe analizimi i të dhënave nuk rezultoi ndryshim sinjifikativ në vendosjen e diagnozës në rastet e vërteta me sepsis(S1/S2apo sepsis i provuar dhe sepsis klinik)  $p>0.05$ . Interesant qe fakti se koha e përjashtimit të diagnozës së sepsisit në rastet ku sepsisi mungonte(format e klasifikuara S3/S4) u shkurtua me rreth 2 ditë dhe diferenca ishte statistikisht sinjifikante mes grupit PCT dhe atij të kontrollit ( $p<.0001$ )

### 3.1.9. Antibiotikoterapi >72 orë

Në praktikën e klinikës foshnjat e dyshuara për infeksion, nisin antibiotikoterapi empirike e cila vazhdon mbi 72 orë, në varësi të kohës së konfirmimit apo përjashtimit të diagnozës së sepsisit neonatal.

**TABELA 10. Antibiotikoterapi >72 orë**

	<i>Grupi i kontrollit</i> <i>N=187</i>	<i>Grupi i studimit (PCT)</i> <i>n=153</i>	<i>Absolute risk reduction (ARR)</i>	<i>P&lt;0.05</i>
<i>Totali</i>	161/187 86%	63/153 41%	45% OR 0.45(0.3-0.48)	0.002
<i>S1+S2</i>	18/18(100%)	10/10(100%)	0%	
<i>S3</i>	94/104 90%	46/83 55%	35% OR 0.36(0.22-0.46)	<0.002
<i>S4</i>	49/64 76%	9/60 15%	61% OR 0.61(0.45-0.72)	<0.002

**Shënim:** U llogarit ARR mes dy grupeve dhe OR përkatëse për CI 95%.

U përdor Fisher exact test (Toë-tailed) për llogaritjen e vlerës së  $p^{së}$ .

**Koment Tabela 10.** Nga analizimi i kohës së përdorimit të antibiotikëve në të dy grupet rezultoi një reduktim me 45% (ARR 45%; OR 0.45(0.3-0.48) Fisher exact test  $p=0.002$ ) i antibiotikoterapisë mbi 72 orë në grupin PCT (të studimit). Nuk u gjet ndryshim në kohëzgjatjen e antibiotikoterapisë në format klinike kur sepsis u provua apo mbetej dyshimi fortë klinik për të.

Ndikimi PCT për të vendosur diagnozën ndihmon në marrjen e vendimit për ndërprerjen e antibiotikoterapisë në një kohë më të shkurtër veçanërisht në grupin S3  $p<0.002$ .

### 3.1.10. Vlerësimi i kohëzgjatjes së Antibiotikoterapisë sipas grupmoshës

Duke qenë se grupi është heterogjen për shkak të karakteristikave të ndryshme të sëmundshmërisë që manifestojnë foshnjat me moshë barre të ndryshme, u bë ndarja në dy grupe me karakteristika të ngjashme brenda grupit;. Brenda çdo grupi u bë rigrupimi i pacientëve në:

- Grupmosha  $\geq 32$  javë &  $\leq 34$  javë;
- Grupmosha  $> 34$  javë.

U bë analizimi i përdorimit dhe kohëzgjatjes së antibiotikoterapisë në të dy grupimet për të dy grupet e përhira në studim.

**TABELA 11. Grupmosha  $\geq 32$  javë &  $\leq 34$  javë dhe Antibiotikoterapi >72 orë**

	<i>Grupi i kontrollit</i> <i>N=112</i>	<i>Grupi i studimit(PCT)</i> <i>n=84</i>	<i>Absolute risk reduction</i> <i>(ARR)</i>	<i>p</i>
<b>Totali</b>	<b>89.2%</b>	<b>75%</b>	<b>14.2%</b> <b>OR 0.42(0.43-0.52)</b>	<b>0.03</b>
<b>S1+S2</b>	<b>9/9(100%)</b>	<b>3/3(100%)</b>	<b>0%</b>	
<b>S3</b>	<b>58/63</b> <b>92.06 %</b>	<b>36/41</b> <b>87.8%</b>	<b>4.2%</b> <b>OR 0.04(0.228-0.66)</b>	<b>0.4</b>
<b>S4</b>	<b>34/40</b> <b>85%</b>	<b>21/40</b> <b>52.5%</b>	<b>32.5%</b> <b>OR 0.32(0.25-0.62)</b>	<b>&lt;0.002</b>

**Koment Tabela 11.** Nga analizimi i kohës së përdorimit të antibiotikëve në **Grupmoshën  $\geq 32$  javë &  $\leq 34$  javë** rezultoi një reduktim me 14.2%(ARR 14.2% ; OR 0.45(0.3-0.48) Fisher exact test  $p=0.03$ ) i antibiotikoterapisë mbi 72 orë në grupin PCT(të studimit) . Nuk u gjet ndryshim në kohëzgjatjen e antibiotikoterapisë në format klinike kur sepsisi u provua apo mbetej dyshimi fortë klinik për të. Gjithashtu nuk u gjet reduktim sinjifikant statistikisht në antibiotikoterapi, mes grupeve të marra në studim, për këtë grupmoshë, edhe në formën klinike S3(sepsis i dyshimtë) ,  $p=0.4$ . Ndikimi PCT për të vendosur diagnozën ndihmon në marrjen e vendimit për ndërprerjen e antibiotikoterapisë në një kohë më të shkurtër veçanërisht në grupin S4  $p<0.002$ .

**TABELA 12. Grupmosha  $>34$  javë dhe Antibiotikoterapi >72 orë**

	<i>Grupi i kontrollit</i> N=75	<i>Grupi i studimit</i> (PCT) n=69	<i>Absolute risk reduction</i> (ARR)	<i>p</i>
<b>Totali</b>	<b>82.6%</b>	<b>35.9%</b>	<b>46.7%</b> <b>OR 0.48(0.23-0.62)</b>	<b>0.002</b>
<b>S1+S2</b>	<b>9/9</b> <b>(100%)</b>	<b>7/7</b> <b>(100%)</b>	<b>0%</b>	
<b>S3</b>	<b>36/40 (90%)</b>	<b>4/52(7.6%)</b>	<b>82.6%</b> <b>OR 0.82(0.22-0.46)</b>	<b>&lt;0.002</b>
<b>S4</b>	<b>17/26(65.3%)</b>	<b>0</b>		<b>&lt;.001</b>

**Koment Tabela 11.** Nga analizimi i kohës së përdorimit të antibiotikëve në **Grupmoshën >34 javë** për të dy grupet e studiuara rezultoi një reduktim me 46.7% (ARR 46.7% ; OR **OR 0.48(0.83-0.2)** Fisher exact test  $p=0.03$ ) i antibiotikoterapisë mbi 72 orë në grupin PCT(të studimit) . Nuk u gjet ndryshim në kohëzgjatjen e antibiotikoterapisë në format klinike kur sepsisi u provua apo mbetej dyshimi fortë klinik për të. Gjithashtu nuk u gjet reduktim sinjifikant statistikisht në antibiotikoterapi, mes grupeve të marra në studim, për këtë grupmoshë, edhe në formën klinike S3(sepsis i dyshimtë) ,  $p=0.4$ . Ndikimi PCT për të vendosur diagnozën ndihmon në marrjen e vendimit për ndërprerjen e antibiotikoterapisë në një kohë më të shkurtër veçanërisht në grupin S4  $p<0.002$ .

### 3.1.11. Kohëzgjatja(Orë) e Antibiotikoterapisë

U vlerësua gjithashtu kohëzgjatja (orë) e përdorimit të antibiotikëve në të dy grupet e studiuara dhe më pas u bë analiza specifike mes të dy grupeve për të dy grupmoshat. U përdor Exact Mann-Ëhitney U test.

**TABELA 13. Orë antibiotikoterapi (totali)**

	<i>Grupi i kontrollit</i>	<i>Grupi i studimit (PCT)</i>	<i>Absolute reduction</i>	<b>p</b>
<i>Totali orë antb</i>	<b>144</b>	<b>120</b>	<b>24</b>	<b>0.82</b>
<i>S1+S2</i>	<b>192</b>	<b>168</b>	<b>24</b>	<b>0.96</b>
<i>S3</i>	<b>120</b>	<b>84</b>	<b>26</b>	<b>0.56</b>
<i>S4</i>	<b>86</b>	<b>48</b>	<b>48</b>	<b>0.42</b>

**TABELA 14. Orë të përdorimit të antibiotikut MB  $\geq 32$  javë &  $\leq 34$  javë**

	<i>Grupi i kontrollit</i>	<i>Grupi i studimit (PCT)</i>	<i>Absolute reduction</i>	<b>p</b>
<i>Totali orë antb</i>	<b>168</b>	<b>120</b>	<b>48</b>	<b>0.39</b>
<i>S1+S2</i>	<b>240</b>	<b>240</b>	<b>0</b>	
<i>S3</i>	<b>120</b>	<b>108</b>	<b>12</b>	<b>0.78</b>
<i>S4</i>	<b>94</b>	<b>72</b>	<b>24</b>	<b>0.57</b>

**TABELA 15. Orë të përdorimit të antibiotikut MB >34 javë**

	<i>Grupi i kontrollit</i>	<i>Grupi i studimit (PCT)</i>	<i>Absolute reduction</i>	<b>p</b>
<i>Totali orë antb</i>	<b>120</b>	<b>96</b>	<b>24</b>	<b>0.46</b>
<i>S1+S2</i>	<b>168</b>	<b>168</b>	<b>0</b>	
<i>S3</i>	<b>120</b>	<b>72</b>	<b>48</b>	<b>0.04</b>
<i>S4</i>	<b>96</b>	<b>48</b>	<b>48</b>	<b>0.04</b>

*Koment Tabelat 13,14,15 . Nuk u gjet ndryshim sinjifikativ në kohëzgjatjen e antibiotikoterapisë në grupmoshën MB  $\geq 32$  javë &  $\leq 34$  javë. Nga të dhënat rezultoi se kemi një shkurtim me të paktën 48 orë të antibiotikoterapisë në MB >34 javë dhe në grupin ku sepsis u përjashtua.*

### 3.1.12. Rifillimi i antibiotikëve brenda 72 orëve nga ndërprerja

U vlerësua nevoja për rillimin e antibiotikoterapisë deri në 72 orë nga ndërprerja.

**TABELA 16. Rifillim i antibiotikoterapisë brenda 72 orëve**

	Grupi i kontrollit	Grupi i studimit	ARR	p
Rifillim i antb	18/187 9.6%	3/153 1.96%	8.5 OR 0.08(0.03-0.14)	.0001

**Koment tabela 16.** Vetëm në 1.96% të rasteve të grupit të studimit ku sipas kritereve të reja ishte ndërprerë antibiotikoterapia u desh të rifillohej antibiotiku për shkak të zhvillimit të një episodi septik, kundrejt 9.6% në grupin e kontrollit. Kjo diferencë mes grupeve është sinjifikante,  $p < .0001$ .



### 3.1.13. Ditëqëndrimi në NICU/spital

**TABELA 17. Ditëqëndrimi NICU**

	<b>Grupi i PCT</b>	<b>Grupi i kontrollit</b>	<b>CI 95%</b>	<b>P&lt;0.05</b>
<b>S1+S2(dite)</b>	17.9±4.8	18.7±7.02	0.8(0.54-2.14)	<b>0.06</b>
<b>S3</b>	9.2±1.4	11.35±2.3	2.15(1.73-2.56)	<b>0.005</b>
<b>S4</b>	6.69±0.8	7.15±1.07	0.46(0.25-0.67)	<b>0.04</b>
	<b>Ditëqëndrimi spital</b>			
<b>S1+S2(dite)</b>	24.5±7.3	25.4±9.5	0.7(-1.14-2.54)	<b>0.14</b>
<b>S3</b>	13.14±	18.2±3.3	3.8(3.23-4.37)	<b>&lt;0001</b>
<b>S4</b>	10.3±1.3	12.8±2.1	2.5(2.12-2.88)	<b>0.008</b>

**Koment Tabela 17.** Aplikimi i protokollit të ri të diagnozës rezultoi edhe me reduktim të ditëqëndrimit të të porsalindurve të grupit të studimit, në NICU dhe ditëqëndrimit total në spital. Ky reduktim shkoi deri në 2 ditë që do të thotë më pak bebe në terapinë intensive, ekspozim më i pakët ndaj rreziqeve ambientale (manipulime, ekzaminime të panevojshme), më pak stres për të porsalindurin dhe nënën. Ndryshimet mes grupeve ishin sinjifikative.

## **KAPITULLI 4**

## **DISKUTIMI**

#### **4.1. Roli i Prokalcitoninës(PCT) në diagnozën e hershme të sepsisit neonatal/Krahasimi i grupeve**

Ky studim, solli përdorimin e një markuesi të ri për diagnozën e hershme të sepsisit neonatal.

Në këtë studim prospektiv intervenues, u arrit të tregohet se PCT mund të dihmohet në vendosjen e hershme të diagnozës së sepsisit neonatal, duke ndikuar në reduktimin e antibiotikoterapisë, në rastet kur sepsisi përjashtohet.

Diskutimi orientohet rreth Objektivit kryesor dhe Objektivave Specifike.

**OBJEKTIVI KRYESOR:** të vlerësojë efektshmërinë e përdorimit të PCT për vendosjen e hershme të diagnozës së sepsisit neonatal në të porsalindurit e dyshuar për infeksion, të lindur parakohe apo në kohë, me karakteristika të ngjashme perinatale.

